

VENDIM
Nr.804, datë 6.12.2006

PËR LIRIMIN DHE ÇAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRIVE
HUAMARRËSE, NË ADMINISTRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7/2 e 7/8 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Illir Laku lirohet nga detyra e administratorit të shoqërisë huamarrëse, në administrim, “Gjallica”.

2. Z.Flamur Laze lirohet nga detyra e administratorit të shoqërive huamarrëse, në administrim, “Nahlel”, “Global Foods”, “Fabiona”, “Univers” e “Beno” dhe të fondacioneve “Populli” dhe “Xhaferri”.

3. Z.Ymer Liksala, administrator i shoqërive huamarrëse, në administrim, “Kamberi”&Co dhe “M.Leka”, caktohet gjithashtu administrator edhe në shoqëritë “Nahlel”, “Global Foodes”, “Fabiona”, “Univers”, e “Beno” dhe në fondacionet “Populli” dhe “Xhaferri”.

4. Ngarkohen Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha